



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE
INSPEKTORATI SHTETËROR SHËNDETËSOR

LISTË VERIFIKIMI PËR SPITAL DITOR TIPI B

Nr.

Datë:

Qarku:

Subjekt i inspektuar për herë të:

1. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME TË SUBJEKTIT

1.	Emri i Subjektit	
2.	Data e Fillimit të aktivitetit	
3.	Lloji i aktivitetit ekonomik	
4.	Adresa - Qendër (Rrugë, Njësi, Telefon)	
5.	Adresa të tjera - Filiale (Rrugë, Njësi, Telefon)	
6.	Përfaqësuesi i subjektit (emër, atësia, mbiemri)	
7.	NUIS - QKR (Nr Unik i Identifikimit)	
8.	Tipi i Pronësisë	Tipi i Subjektit

LISTË VERIFIKIMI PËR SPITAL DITOR TIPI B

Emri i Subjektit:

Drejtues teknik:

Specialiteti Mjekësor:

Numri i përgjithshëm i personelit:

Pajisje me burim rrezatimi:

Në zbatim të ligjit nr. 10107 datë 30.03.2009 “Për kujdesin shëndetësor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 55/2022, datë 07.07.2022 “Për shërbimin spitalor në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 147/2014 datë

30.10.2014 “Për shërbimin e urgjencës mjekësore”, ligjit nr. 8045 datë 07.12.1995 "Për ndërprerjen e shtatzënisë", ligjit nr. 8876 datë 04.04.2002 "Për shëndetin riprodhues", ligjit nr. 10454 datë 21.07.2011 “Për transplantimin e indeve, qelizave dhe organeve në republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 10469 datë 13.10.2011 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jojonizuese”, i ndryshuar, ligjit nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, ligjit nr. 8032 datë 16.11.1995 “Për shërbimin e transfuzionit dhe kontrollin e gjakut, produkteve të tij dhe transplantimeve”, ligjit nr. 8025 datë 9.11.1995 “Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese” i ndryshuar, ligjit nr. 7643 datë 02.12.1992 “Për inspektimin sanitar”, i ndryshuar, ligjit nr. 15/2016, datë 10.03.2016 “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, ligjit nr. 9636 datë 06.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, i ndryshuar, vkm nr. 865 datë 24.12.2019, “Për mënyrën e kryerjes së procesit të akreditimit të institucioneve të kujdesit shëndetësor e përcaktimin e tarifave dhe afateve kohore”, vkm nr. 237, datë 06.03.2009 “Për përcaktimin e kriterëve për hapjen dhe mbylljen e spitaleve”, i ndryshuar, vkm nr. 639 datë 07.09.2016, “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, urdhër nr. 416 datë 12.10.2011, për miratimin e rregullores për “Procedurat e importimit dhe eksportimit të indeve, qelizave dhe organeve me origjinë njerëzore për qëllim transplantimi”; rregullore e ministrisë së shëndetësisë “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes, përdorimit të gjakut dhe komponentëve të tij në spitalet e republikës së Shqipërisë” 2015, udhëzim i ministrisë së shëndetësisë nr. 510 datë 13.12.2011 “Për inspektimet higjieno sanitare në funksion të lëshimit të akt miratimit higjieno sanitar”

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
1	Neni 27, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009; Kapitulli III, shtojca III, vkm nr. 237, datë 06.03.2009.	A është i licencuar subjekti për spital ditor i klasës "B"?		
2	Neni 26, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009; Pika 1, 2 dhe 3, vkm nr. 865, datë 24.12.2019.	A është akredituar subjekti (apo është në proces) nga institucioni përgjegjës, në mënyrë periodike, për të vlerësuar shkallën e plotësisë nga ana e tyre të standardeve të paracaktuara dhe të publikuara për to nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë?		
3	Neni 10, ligji nr. 7643, datë 02.12.1992; Udhëzim nr. 510, datë 13.12.2011.	A ka objekti Akt Miratim higjieno sanitar dhe a përputhet ky dokument me aktivitetin aktual të subjektit?		
4	Pika 2, aneksi II, vkm nr. 237 datë 06.03.2009.	A ka spitali rregullor brendshëm për funksionimin e tij?		
5	Germa a, neni 13, ligji nr. 7643, datë 02.12.1992; Germa a, pika 1, pika 3, vkm nr. 639, datë 07.09.2016.	A është personeli i pajisur me raport mjekoligjor (KML)?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
6	Germa d, pika 1, neni 6, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016;	A është kryer shërbimi DDD, dhe a disponon subjekti certifikatën e këtij shërbimi?		
7	Pika 2, neni 30, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009.	A raporton spitali në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Shëndetësisë për aktivitetin spitalor, sëmundshmërinë?		
8	Pika 4, neni 30, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009.	A ruhet konfidencialiteti i pacientit?		
9	Neni 5, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.	A realizohet njoftimi dhe raportimi i sëmundjeve infektive?		
10	Neni 21, ligji nr. 7643, datë 02.12.1992; Urdhër nr. 369, datë 26.09.2017.	A është personeli i pajisur me librezë shëndetësore?		
11	Neni 6, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.	A realizohet marrja e masave të përgjithshme për mbrojtjen nga sëmundjet infektive?		
12	Neni 7, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.	A realizohet marrja e masave të veçanta për mbrojtje nga sëmundjet infektive?		
13	Germa dh, neni 6, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.	A është personeli i pajisur me uniformat e punës?		
14	Germa b, neni 13, ligji nr. 7643, datë 02.12.1992; Neni 6, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.	A ka në objekt ujë të rrjedhshëm higjienikisht të pastër të dedikuar për konsum njerëzor, rezerva ujore të mjaftueshme në rast të ndërprerjes së furnizimit dhe ujë të ngrohtë?		
15	Neni 21, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009; Germa d, pika 2, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka subjekti burim të furnizimit me rrymë elektrike të pandërprerë dhe sistem të pavarur ushqimi elektrik (gjenerator) për sigurimin e vazhdimësisë së rrymës elektrike?		
16	Germa ç, pika 2, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor sistem për mbrojtjen nga zjarri dhe materialet shpërthyesë, si dhe kontratën me SHMKZ-në?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
17	Pika 2, kapitulli I, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A është e përfshirë ndërtesa e spitalit ditor në ndërtesën e spitalit publik/jopublik, në një ose disa reparte të dedikuara?		
18	Pika 1, kapitulli I, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A është e përfshirë ndërtesa e spitalit ditor në strukturën e një ndërtese të veçantë?		
19	Pika 2, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237 datë 6.3.2009; Pika 1, kreu II, VKM nr. 401 datë 25.06.2004.	A respekton Spitali ditor normat urbanistike dhe të arkitekturës sipas legjislacionit në fuqi dhe a siguron aksesueshmëri në mjediset e tij për personat me aftësi të kufizuar në veçanti, sipas standardeve të miratuara?		
20	Shkronja b, neni 13, ligji nr. 7643 datë 02.12.1992; Udhëzim nr. 510 datë 13.12.2011.	A plotëson objekti standardet higjieno – sanitare sipas kërkesave ligjore (lyerja, ndriçimi, temperature, ventilimi, furnizimi me ujë) të hapësirave të brendshme dhe të jashtme?		
21	Shkronja b, neni 13, ligji nr. 7643 datë 2.12.1992; Udhëzim nr. 510 datë 13.12.2011.	A përbëhet mjedisi i brendshëm nga ndarjet e nevojshme për kryerjen e aktivitetit?		
22	Shkronja b, aneksi 1, vkm nr. 237 datë 06.03.2009	A siguron zbatimin e rregullores për numrin e shtretërve sipas kapacitetit të dhomave?		
23	Pika 6, neni 9,pika 2, neni 15, ligji nr. 55/2022 datë 07.07.2022.	A siguron mbrojtjen e shëndetit në bashkëpunim edhe me veprimtaritë e institucioneve te tjera shëndetësore?		
24	Pika 6, neni 14, ligji nr.147/2014, datë 30.10.2014; Germa d, pika 3, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237 datë 6.3.2009.	A plotësohet standardi infrastrukturor ndërtimor, i pajisjeve mjekësore dhe lista e medikamenteve të nevojshme të urgjencës sipas urdhrin të Ministrit të Shëndetësisë?		
25	Neni 25, ligji nr. 9739, datë 21.05.2007; Germa dh, pika 3, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor marrëveshje paraprake me Shërbimin Kombëtar të Transfuzionit të Gjakut dhe a e dokumenton struktura spitalore që përdor gjak dhe komponentë të tij në përputhje me rregulloren “Për procedurën e kërkimit, përzgjedhjes dhe përdorimit të gjakut dhe komponentëve te tij në spitalet e Republikës së Shqipërisë?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
26	Germa e, pika 3, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor shërbim sterilizimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi, të siguruar nga vetë institucioni ose të kontraktuar ?		
27	Germa b, pika 5, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor një drejtues mjekësor i cili përgjigjet personalisht për organizimin tekniko-funksional, për standardet dhe ecurinë e shërbimeve higjieno-sanitare?		
28	Germa b, pika 5, kapitulli II shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor të paktën një mjek dhe një infermier për çdo njësi (specialitet) shërbimi mjekësor dhe stafin ndihmës, në raport me numrin e aktiviteteve mjekësore të ofruara për çdo shërbim (repart) të spitalit ditor?		
29	Pika 3, neni 30, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009; Pika 6, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ruhen të dhënat që krijohen nëpërmjet grumbullimit dhe evidentimit të dokumentacionit shëndetësor sipas legjislacionit në fuqi?		
30	Neni 6, neni 7, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016; Pika 8, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A disponon Spitali ditor një program dhe një person përgjegjës të kontrollit të infeksionit spitalor?		
31	Germa b, neni 7, ligji nr. 15/2016, datë 10.03.2016.; Pika 8, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A kryhet kontrolli dhe parandalimi i infeksionit spitalor në përputhje me përcaktimet e legjislacionit në fuqi për kontrollin dhe luftimin e sëmundjeve infektive?		
32	Pika 1, neni 2, ligji nr. 10463, datë 22.09.2011; Germa ç, pika 8, kapitulli II, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009	A ka subjekti dokument tip, “Kontratë për administrimin e mbetjeve spitalore” e institucionit shëndetësor prodhues të mbetjeve spitalore me kompanitë e licencuara për trajtimin e tyre?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
33	Pika 31, pika 34, germa C, germa B, “Kritere të veçanta të ndërtimit”, aneksi i, vkm nr. 237, datë 6.3.2009; Udhëzim nr. 510, datë 13.12.2011.	A plotëson spitali ditor standardet e kërkuara në shërbimet e lavanderisë, gardërobës, kuzhinës dhe magazinimit?		
34	Pika 1, kapitulli III A, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A kryen Spitali ditor i klasës "B" çdo procedurë mjekësore që përfshin administrimin e një bari anestetik spinalë, epiduralë ose të përgjithshëm?		
35	Germa b, pika 1, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" një kapacitet jo më shumë se 10 shtretër për çdo sallë operacioni?		
36	Germa a, pika 1, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A kryen Spitali ditor i klasës "B" Kirurgji ditore e cila përfshin shtrimin në spital të pacientit për jo më shumë se 24 orë?		
37	Germa c, pika 2, kapitulli III , shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor mjedis qëndrimi dhe pritjeje për pacientët dhe vizitorët?		
38	Germa ë, pika 2, kapitulli III A, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor shërbim diagnostikues imazherik ?		
39	Germa a, neni 3, ligji nr. 8025, datë 09.11.1995	A ka në subjekt pajisje me burime të rrezatimit jonizues?		
40	Neni 4, ligji nr. 8025, datë 09.11.1995.	A është subjekti i pajisur me licencë nga KMR për kryerjen e veprimtarive me burimet e rrezatimit jonizues?		
41	Germa dh, pika 2, kapitulli III, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor mjedis të dedikuar për ruajtjen e barnave dhe të materialeve mjekësore?		
42	Germa f, pika 2, kapitulli III, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka spitali ditor shërbim laboratorik për analiza kimike- klinike?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
43	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A përfshin në Spitalin ditor të klasës "B" shërbimi në kirurgjinë ditore ekzaminimet dhe vizitat mjekësore përpara ndërhyrjes kirurgjikale, ndërhyrjen kirurgjikale dhe vizitat mjekësore pas ndërhyrjes kirurgjikale?		
44	Germa d, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A përfshin në Spitalin ditor shërbimi në kirurgjinë ditore ndërhyrjet që janë të programuara, kohëzgjatja e tyre është mesatarisht 2 orë dhe kanë rrezik të ulët komplikacioni post operator?		
45	Germa a, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" mjekë kirurg të specializuar në përputhje me specialitetin përkatës, mjekë anestezist, infermierë dhe stafin mjekësor ndihmës në raport me numrin e aktiviteteve mjekësore të ofruara për çdo shërbim?		
46	Germa b, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka në Spitalin ditor të klasës "B" gjatë orëve kur kryen ndërhyrje kirurgjikale praninë e të paktën, një mjeku kirurg të specializuar në nën specialitetin përkatës, një mjeku anestezist, një kryeinfermieri ose të paktën dy infermierë dhe personel mjekësor në gatishmëri 24 orë?		
47	Germa c, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A përfshin infrastruktura e Spitalit ditor të klasës "B": salla operatore/blloku operator, zonën e vëzhgimit post operator, me një, dy ose disa shtretër, dhomë të pacientëve me jo më shumë se katër shtretër, të pajisur me tualetin përkatës, dhomën e vizitës dhe të mjekimit?		
48	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A plotëson struktura ndërtimore e Spitalit ditor të klasës "B" kriteret për: dhomat me një shtrat jo më të vogla se 12 m ² , dhomat me dy shtretër jo më pak se 8 m ² për çdo shtrat pacienti dhe një pajisje qendrore oksigjeni dhe vakumi të veçantë për çdo shtrat?		
49	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" ambientin e infermierisë pranë dhomave të pacientëve, të pajisur me lavaman, me vend ku përgatitet mjekimi, si dhe me një sistem thirrës emergjence, që lidhet me çdo dhomë të pacientëve?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
50	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka në Spitalin ditor të klasës "B" në çdo sallë të operacionit vetëm një shtrat operacioni, sipërfaqja e sallës 20 (njëzet)m ² , me lartësi të paktën 2.6 metra, sistem kondicionimi qendror (UTA) me filtra antibakterialë, me qarkullim fluksi laminar dhe presion pozitiv dhe korridori të bllokut operator, në zonën ku transportohen pacientët me gjerësi të paktën prej 1.8m?		
51	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" në bllokun operator hapësirën e sallës së operacionit komplet sterile?		
52	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" në ato pjesë të bllokut operator ku sterilizimi është jo i plotë, një vend pushimi për personelin, dhoma të ndara zhveshjeje dhe veshjeje, dhomë tualeti me dush, depo të materialeve të pastra?		
53	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" korridoret në repartin e shtrimit, ku lëvizin barelat të gjera jo më pak se 1.8 metra?		
54	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" i vendosur në një godinë me më shumë se një kat, një dalje alternative emergjence?		
55	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" muret dhe tavanet e dhomave e të korridoreve , dyshemetë dhe veshjet e dyshemeve të mirë rregulluara, të ndërtuara në mënyrë të tillë që mund të pastrohen lehtësisht dhe të mirëmbahen?		
56	Germa ç, pika 2, kapitulli III B, shtojca III, vkm nr. 237, datë 6.3.2009.	A ka Spitali ditor i klasës "B" një vend praktik me, të paktën, një tualet me lavaman për, personelin e administratës, personelin mjekësor dhe vizitorët e të afërmit e pacientëve, të veçanta për gra dhe për burra?		
57	Pika 1, neni 22, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009	A është cilësia dhe siguria e kujdesit shëndetësor në përputhje me standardet?		
58	Pika 2, neni 21, ligji nr. 10107, datë 30.03.2009.	A plotëson subjekti normat dhe standardet e shërbimeve të kujdesit shëndetësor?		

Nr .	Baza Ligjore	Pyetja	Vlerësimi(Po/Jo/ Nuk Aplikohet)	Komente
59	Neni 15, neni 16, ligji nr. 9636, datë 06.11.2006.	A zbatohet ligji për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit?		

INSPEKTORËT